

Qendra e Personel Rekrutimit, ka filluar regjistrimin e kandidatëve për të ndjekur kursin “**Commissioning course**”, i cili do të zhvillohet në periudhën 27 nëntor 2017-14 dhjetor 2018 në Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst, në Britaninë e Madhe dhe “**Initial Officer Training**”, i cili do të zhvillohet në periudhën 01 janar-20 korrik 2018 në Cranwell të Britanisë së Madhe, për **2 (dy)** të drejta studimi.

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë QPR është deri në **18 tetor 2017**.

1. Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Për kursin “Commissioning course”.

- Të ketë shtetësi shqiptare.
- Të jetë në moshë jo më shumë se 25 vjeç e 9 muaj, në ditën e fillimit të vitit akademik (sipas ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura).
- Të jenë **ushtarak/civil** të cilët kanë përfunduar studimet bachelor, brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë.
- Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë brenda dhe jashtë vendit.
- Të ketë notën mesatare të lëndëve të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jo më pak se 6 (gjashtë).
- Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor.
- Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 cm për femrat e me peshë trupore jo më pak se 50 kg.
- Të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi. Kjo kërkesë aplikohet për kandidatët që nuk janë pjesë e FA.
- Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformatojnë pamjen.
- Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatite, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike.
- Ky burim është i hapur edhe për ushtarakët e Forcave të Armatosura, të cilët kanë kryer arsimin e lartë dhe plotësojnë kriteret e kërkuara.
- Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze në të lexuar, të shkruar dhe të folur dhe të sigurojnë mbi 75 pikë në testimin ALCPT ose 2/2/2/2 STANAG 6001. Ata duhet të kenë njohuri të gjuhës angleze në nivelin **IELTS minimumi 5.5 pikë**.
- Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se:
 - a) Zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë;
 - b) Kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak;

- c) Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet.
- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, skualifikohet.

Për kursin “Initial Officer Training”.

- Të ketë shtetësi shqiptare.
 - Të jetë në moshë jo më shumë se 26 vjeç e 2 muaj, në ditën e fillimit të vitit akademik (sipas ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura).
 - Të jenë ushtarak/civil të cilët kanë përfunduar studimet bachelor në degët **inxhinieri elektronike dhe inxhinieri mekanike**, brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë.
 - Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë brenda dhe jashtë vendit.
 - Të ketë notën mesatare të lëndëve të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jo më pak se 6 (gjashtë).
 - Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor.
 - Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 cm për femrat.
 - Të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi. Kjo kërkesë aplikohet për kandidatët që nuk janë pjesë e FA.
 - Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformatojnë pamjen.
 - Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatite, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike.
 - Ky burim është i hapur edhe për ushtarakët e Forcave të Armatosura, të cilët kanë kryer arsimin e lartë dhe plotësojnë kriteret e kërkuara.
 - Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze në të lexuar, të shkruar dhe të folur dhe të sigurojnë mbi 75 pikë në testimin ALCPT ose 2/2/2/2 STANAG 6001. Ata duhet të kenë njohuri të gjuhës angleze në nivelin **IELTS minimumi 5.5 pikë**.
 - Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se:
- d) Zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë;
- e) Kanë fituar më parë statusin e studentit ushtarak;
- f) Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet.
- Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, skualifikohet.

2. Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Rekrutimit dhe Pranimit Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve ushtarake në kurset “**Commissioning course**” dhe “**Initial Officer Training**”, të cilët do të zhvillohen në Britanisë së Madhe.
- Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, **ANEX A**.
- Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me listën e notave.
- Fotokopje e kartës së identitetit.
- Certifikatë familjare 1 (një) copë.
- Fotografji për dokument (4x6), 2 (dy) copë.
- Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit.
- Një raport ose vërtetim nga mjeku i familjes ku deklarohet se kandidati është klinikisht i shëndetshëm dhe grupin e gjakut.
- Certifikatë për IELTS

Nëse kandidati shpallet fitues duhet të sjellë edhe dokumentet e mëposhtme:

- Dëshmi penaliteti.
- Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor.
- Vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi.
- Vërtetim nga përmbarimi.

Dokumentet mjekësore.

1. Raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni mjeko – ligjor (KML) nga Njësia Mjekësore Ushtarake.
2. Ekzaminimet për agjentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, HIV/AIDS), të lëshuar nga Njësia Mjekësore Ushtarake.

Në momentin e aplikimit pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit çdo kandidatë duhet të plotësojë një formular vetë deklarami për gjendjen e tij shëndetësore.

3. Datat e testimit:

| | |
|--------------------------------|-------------------|
| Testi Fizik: | 19.10.2017 |
| Testi i Gjuhës së Huaj: | 19.10.2017 |
| Testi Intelektual: | 20.10.2017 |
| Testi Psikologjik: | 20.10.2017 |

4. Të dhënat tabelore të Testimit të Aftësive Fizike:

Për kursin “Commissioning course”.

Për meshkujt:

- Të vrapojë 2.4 km për 10 minuta e 30 sekonda
- Të vrapojë 800 m 4 min e 50 sekonda
- Ulje-ngritje mbi duar 44
- Palosje-shpalosje 50
- Të notojë 100 m

Për femrat:

- Të vrapojë 2.4 km për 12 minuta e 45 sekonda
- Ulje-ngritje mbi duar 20
- Palosje-shpalosje 50
- Të notojë 100 m

Për kursin “Initial Officer Training”.

Për meshkujt:

- Të vrapojë 2.4 km për 11 minuta e 11 sekonda
- Ulje-ngritje mbi duar 20
- Palosje-shpalosje 35

Për femrat:

- Të vrapojë 2.4 km për 13 minuta e 23 sekonda
- Ulje-ngritje mbi duar 10
- Palosje-shpalosje 32

Shënim: Përzgjedhja e kandidatëve të bëhet edhe nga kandidatët të cillët sapo kanë përfunduar testimet për Kursin e Arsimimit të Përgjithshëm të Oficerit.

Njoftimi të botohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe në gazetën “Ushtria” deri në datën 18.10.2017.

Faleminderit për bashkëpunimin.